

Mbrojtja Juridike e Viktimës së Krimit

Avni PUKA*

Abstrakt: *Sot në shkencën dhe praktikën bashkëkohore krimi, kryesi dhe viktima trajtohen si pjesë e të njëjtit problem të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe jo si çështje të ndara. Kjo padyshim se është në funksion të luftimit me efikas të kriminalitetit dhe mbrojtjes së shoqërisë në përgjithësi.*

Qëllimi i këtij punimi është vënia në pah e rëndësisë dhe nevojës për mbrojtjen e pozitës së viktimës së krimit nga aspekti i rregullimit me norma juridike. Çështjet në lidhje me viktimat e krimit duhet të rregullohen juridikisht dhe të drejtat e tyre të jenë pjesë integrale e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Ky është një konstatim që e mbështesin të gjitha dokumentet ndërkombëtare të nxjerra me qëllim të mbrojtjes së viktimave të krimit. Duke marrë parasysh se aktet ndërkombëtare nuk mund të jenë gjithëpërfshirëse, lind nevoja që përveç ratifikimit dhe pranimit të këtyre akteve shtetet të nxjerrin edhe norma juridike vetanake varësisht nga specifikat e tyre dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare. Andaj, objekt studimi në këtë punim do të jenë të drejtat juridike të viktimës së krimit sipas dokumenteve ndërkombëtare dhe normave nacionale me theks të veçantë në legjislacionin e Kosovës prej momentit të pësimin nga akti kriminal e deri në përfundim të çështjes penale në tërësi.

Në këtë punim do të përdoren disa metoda si: ajo historike, metoda e hulumtimit të dispozitave juridike, mandej metoda krahasuese, metodat statistikore etj. Jemi të bindur se ky punim me të dhënat dhe konstatimet e pavarura shkencore mund të jetë një kontribut modest për avancimin e studimeve mbi viktimat, në veçanti nga aspekti i mbrojtjes juridike të pozitës së tyre.

Fjalët çelës: *Viktima e krimit, viktimizimi dhe riviktimizimi, mbrojtja juridike, të drejtat ligjore të viktimës së krimit.*

1. Hyrje

Përderisa në gjithë botën interesimi për krimin, kryesin ka qenë shumë i hershëm, duke i trajtuar gjerësisht në teori, duke nxjerrë ligje, interesimi dhe trajtimi i viktimës së krimit është relativisht i ri.¹ Përcaktimin tim për trajtimin e kësaj problematike, mendoj se e arsyeton vetë aktualiteti, shqetësimi i shoqërisë për viktimën dhe mbrojtjen saj. Në anën

* Fakulteti Juridik (Katedra e shkencave juridike-penale), Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë.
Autori mirëpret komente në: av.puka@gmail.com.

tjetër, si në shumë vende të tjera (që janë në tranzicion) edhe në Kosovë paraqitet si nevojë e kohës studimi, hulumtimi dhe kërkimi shkencor në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me viktimën e krimit, në veçanti me pozitën e saj në sistemin e drejtësisë penale.

Në shumë vende që janë me të avancuara sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi, gjithashtu ka edhe një orientim serioz dhe qasje praktike për trajtim adekuat dhe dinjitoz të personave që kanë pësuar nga krimi në çfarëdo forme. Për këtë janë nxjerrë edhe shumë konventa, rregullore, rekomandime, deklarata, ligje për të garantuar mbrojtje nga aspekti juridik dhe janë ngritur institucione të posaçme me qëllim sigurimin e një sistemi sa më të fuqishëm të drejtësisë për mbrojtjen e pozitës së viktimës së krimit. Megjithëse ka një përparim sa i përket të drejtave të viktimës së krimit, ende nuk ka barazi në raport me kryesin në rrafshin e trajtimit juridik të pozicioneve të tyre si subjekte të aktit kriminal.

Tashmë dihet se ka një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve, asociacioneve, qendrave strehimore-rehabilituese dhe grupeve të tjera që ofrojnë ndihmë në forma të ndryshme për palët e dëmtuara nga aktiviteti kriminal. Ky kontribut i tyre është shumë i madh dhe i nevojshëm, madje në disa raste këto grupe janë mbështetja e vetme për viktimat e krimit, sidomos pas përfundimit të procedurës gjyqësore në lidhje me rastin penal. Mirëpo sadoqë puna e tyre është e dobishme ato nuk udhëheqin procesin gjyqësor dhe nuk kanë kompetencë për nxjerrjen e normave juridike detyruese për garantimin e të drejtave të personave që pësojnë nga krimi. Andaj nga ky aspekt, roli i institucioneve shtetërore është i pazëvendësueshëm, për arsye se rregullimi juridik i të drejtave të viktimës i mundëson asaj qasje të efektshme në procedurë dhe realizim të interesave, në anën tjetër krijohen kushte edhe për mekanizmat joqeveritarë që të ofrojnë shërbime alternative për viktimat. Kjo njëherësh është në frymën e rekomandimeve kryesore të akteve ndërkombëtare që i dedikohen përmirësimit të pozitës së viktimës.

Duhet theksuar se iniciativat për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe realizimin e të drejtave të tyre janë të mirëseardhura nga të gjithë, mirëpo iniciativa e institucioneve ligjvënëse për nxjerrjen e normave juridike në këtë drejtim ka një rëndësi të posaçme. Sepse një mbrojtje adekuate e viktimës së krimit në rend të parë nënkupton një përcaktim të saktë të të drejtave të saj me akte juridike, në mënyrë që e gjithë ndihma që i ofrohet viktimës së krimit të burojë nga të drejtat e saj ligjore. Në fund të kësaj hyrje të punimit është me rëndësi të theksohet se kur flasim për rregullim e çështjeve të caktuara nga aspekti juridik është veçori se përderisa në rastet e tjera sot ka bazë juridike, por problemi kryesor është zbatimi në praktikë i atyre dispozitave ligjore, në rastin e çështjeve që kanë

të bëjnë më viktimat e krimit përveç zbatimit praktik problem në vete është edhe mungesa e normave juridike adekuate.

2. Aspekti historik i trajtimit të viktimës së krimit

Në krahasim me trajtimin e kryesit të krimit, trajtimi i viktimës është shumë i ri. Sigurisht se edhe në të kaluarën, viktimat e krimit ka qenë e njohur si nocion, si subjekt i aktit kriminal por nuk është marrë në konsideratë nevoja e saj për një mbrojtje apo kompensim të domosdoshëm. Pozita e vështirë e viktimës së krimit është e njohur qysh nga sistemet e hershme të drejtësisë. Kodi i Hamurabit në shekullin e tetëmbëdhjetë (p.K) parashihte se viktimat e grabitjeve në rrugë duhet të zhdëmtohen për humbjet e tyre nga thesari i kryetarit². Mirëpo edhe në këtë kohë edhe shumë e shumë kohë më vonë pozita e viktimës nuk është përmirësuar sa duhet. Në aspektin historik vërehet përpjekja e autorëve të ndryshëm për të kontribuar, për të vënë në pah domosdoshmërinë e njohjes me nevojat e viktimës që ka pësuar nga krimi, për ta njohur raportin e saj me kryesin dhe nevojën për mbrojtje.

Në mesin e autorëve që njihen edhe si pionierë të shkencës së viktimologjisë dallohet kontributi i Hans V. Hentingut i cili në vitin 1948 boton librin e tij “Krimi dhe viktimat e tij”. Në këtë libër ai thekson se krimi në pjesën më të madhe dëmton dikë. Andaj mendon se në kuadër të mënjanimin të kriminalitetit kundër shtetit, rendit, shëndetit dhe të tjerave duhet të kihet parasysh se gjithmonë janë dy pjesëmarrës, autori i krimit dhe viktimat³. Në kohën me të re, përkatësisht në kah fundi i viteve 1970 dhe fillimi i viteve 1980, në shumë vende, është bërë një ngritje e përgjithshme e vetëdijes mbi nevojën e përqendrimit të vëmendjes në viktimat e krimit dhe për të siguruar një sistem të gjithanshëm të drejtësisë.⁴

Në këtë drejtim ka qenë shumë me rëndësi kontributi i Këshillit të Evropës dhe OKB-së për mbrojtjen e viktimave të krimit që konsiston kryesisht në nxjerrjen e një numri të madh të akteve juridike për këtë qëllim. Mandej nga organizatat joqeveritare vlen të përmendet edhe roli i “Shoqatës Botërore për Viktimologji” (The World Society of Victimology – WSV) që gjatë veprimtarisë së saj ka organizuar disa simpoziume ndërkombëtare çdo tri vite me fillim nga viti 1973 dhe ka iniciuar një sërë aktesh juridike për mbrojtjen e viktimave. Kjo shoqatë ka disa asociacione në vende të ndryshme, në

² Adler, Freda dhe të tjerë: Criminology, New York, 1995, fq. 397.

³ Henting, Hans Von: The criminal and his victim, Archon Books, 1967, fq. 383.

⁴ Udhëzues për mbrojtjen e viktimave-Si të punohet me viktimat e krimit, OSCE, Misioni në Kosovë, Prishtinë, 2001, fq. 44 (më tutje i referohemi si Udhëzuesi).

mesin e tyre edhe në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovinë⁵. Mund të themi se pozita e viktimës së krimit historikisht ka ndryshuar shumë. Nga pozita kur të drejtat e saj nuk janë mbrojtur me ligj, vetëm është njohur si subjekt i krimit dhe është shfrytëzuar si burim provash, deri sa tani të drejtat e saj janë njehsuar plotësisht me të drejtat e njeriut në tërësi. Në funksion të kësaj janë miratuar dhe fuqizuar shumë akte juridike. Por, prapë mbetet shumë aktuale nevoja për të përmirësuar statusin juridik të viktimave të krimit sidomos në vendet që nuk kanë bërë sa duhet në këtë drejtim.

3. Të drejtat ligjore të viktimës së krimit

Kur bëhet fjalë për rregullimin e pozitës së viktimës së krimit në aspektin juridik, në rend të parë është e nevojshme që të përcaktohet saktë kush konsiderohet viktimë e tillë. Sipas Deklaratës së KB-së ...viktimat nënkuptojnë personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike apo mentale pësimet emocionale, humbjet ekonomike apo keqësimin substancial të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat paraqesin shkelje të ligjeve penale në fuqi në kuadër të shteteve anëtare, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e pushtetit⁶.

Përkufizimi i viktimës sipas kësaj deklarate është njëherësh edhe me gjithëpërfshirës. Në bazë të deklaratës personi konsiderohet viktimë pavarësisht a është identifikuar kryesi apo si është trajtuar ai, po ashtu si viktimë konsiderohen anëtarët e familjes, personat që varen nga viktima drejtpërdrejt dhe personat të cilët kanë pësuar lëndime për shkak se kanë ndërhyrë në mënyrë që t'u dalin në ndihmë viktimave dhe të parandalojnë viktimizimin e tyre.⁷ Përkufizim i palës që ka pësuar nga krimi – viktimës është i përcaktuar edhe me ligjet nacionale që me shpesh përdoret si i dëmtuar apo palë e dëmtuar. Sipas nenit 151(5) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës: “I dëmtuari” është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale⁸.

Mandej sipas rregullores 2001/20, Për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurën penale, termi “palë e dëmtuar” i referohet personit të dëmtuar ose të kërcënuar me një krim që lidhet me ndonjë të drejtë të tij personale a pronësore ose të një anëtari të familjes së palës së dëmtuar, i cili përfaqëson interesin e një pale të dëmtuar që

⁵ Më gjerësisht shih: www.worldsocietyofvictimology.org.

⁶ Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985 (më tutje i referohemi si Deklarata e OKB-së).

⁷ Po aty.

⁸ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004 (më tutje i referohemi si KPPK).

ka vdekur ose është i mitur dhe i cili, përndryshe, nuk është i aftë për të përfaqësuar interesin e tij a të saj në gjykatë⁹. Nga dispozitat përkatëse në Kosovë vërehet se për personat që kanë pësuar nga veprat penale përdoret termi “i dëmtuar” ose “palë dëmtuar” dhe nuk përdoret termi viktimë. Në praktikën bashkëkohore i kushtohet rëndësi e madhe përkufizimit preciz se kush konsiderohet viktimë direkte dhe indirekte e krimit, sepse nga kjo varet rrethi i personave që u ofrohet ndihma dhe të cilët mund të kërkojnë kompensim për humbjet që i kanë pësuar. Andaj edhe në dispozitat juridike në Kosovë që i dedikohen kësaj fushe ka shumë rëndësi definimi i saktë i rrethit të personave që konsiderohen viktimë e krimit, pa lënë zbrastësi dhe mundësi për keqinterpretime.

Sot në tërë botën është vërtetuar si domosdoshmëri që krahas të drejtave të kryesit në nivel të njëjtë dhe me një ndjesi edhe me të madhe të rregullohen juridikisht edhe të drejtat e viktimës së krimit. Garantimi i të drejtave dhe trajtimi i viktimave të krimit në pajtim me to, përveç që është në funksion të parimit të humanitetit dhe mbrojtjes nga riviktimizimi, kjo ka rëndësi të madhe edhe për preventivën e krimit. Kur flasim për të drejtat e viktimës, duke filluar nga e drejta themelore për jetë, për pronësi për mbrojtje shëndetësore apo mbrojtje tjetër, kompensim etj, kemi parasysh të drejtat ligjore të saj. Për promovimin e të drejtave të viktimave të krimit deri tani janë një numër i akteve juridike të nxjerra nga OKB-ja në nivel të përgjithshëm, nga Këshilli i Evropës në nivel rajonal që mendojmë se janë me rëndësi të veçantë për Kosovën dhe vendet e tjera të Europës.

Derisa nuk ka konventë universale përkitazi me të drejtat e viktimave të krimeve të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara aprovoi, më 1985, *Deklaratën e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit*, teksti i së cilës u aprovua me konsensus nga kongresi i shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin e krimit dhe trajtimin e kundërvajtësve. Për të promovuar implementimin u përgatitë një *Udhëzues për praktikuesit* përkitazi me implementimin e Deklaratës¹⁰. Në nivel Evropian gjithashtu janë miratuar një varg dokumentesh me qëllim të avancimit juridik të pozitës së viktimës, ndër to vlen të përmendën: *Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të krimit* e vitit 1983, rekomandimet si: *Rekomandimi Nr. (85) 11 mbi pozitën e viktimave në kornizën e ligjit penal dhe të procedurës penale*, që rregullon pozitën e viktimës prej momentit të pësimit, gjatë

⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/20, Për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedurën penale. Neni 1(a).

¹⁰ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë: Doracak për të drejtat e njeriut për gjykatës, prokurorë dhe avokatë, Publikim i Kombeve të Bashkuara, Nju-Jork dhe Gjenevë, fq. 735-736.

marrjes në pyetje për here të parë si dhe mbrojtjen e saj në të gjitha fazat e procedurës penale. Si akte të tjera që përcaktojnë të drejtat e viktimave të krimit në nivel evropian janë: *Rekomandimi Nr.4/85 Mbi mbrojtjen e viktimave në familje; Rekomandimi nr. 21/87 Mbi mbështetjen e viktimave dhe Parandalimin e Viktimizimit; Rekomandimi nr. 8/2006 Mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit etj.*¹¹

Sigurisht se këto akte ndërkombëtare në nivel universal apo rajonal nuk janë zgjidhja e problemit andaj kërkohet që në pajtim me to por në mënyrë më të detajuar të drejtat e viktimave të rregullohen edhe në nivel të shteteve me ligje nacionale. Në Kosovë të drejtat e viktimave të krimit dhe mundësia për realizimin e tyre janë paraparë në kodin e procedurës dhe disa rregullore të UNMIK-ut, pjesërisht edhe në akte të tjera por mendojmë se nuk janë të mjaftueshme. Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës (KPPK) parasheh mbrojtje të pozitës së të dëmtuarit gjatë procedurës penale, e në veçanti kur është fjala për fëmijë, persona të moshuar me çrregullime mendore për viktimat e dhunës seksuale e gjinore (neni 78). I dëmtuari ka të drejtë që në procedurë penale të paraqes kërkesë pasurore juridike, të paraqes fakte dhe propozojë prova, të shikojë procesverbalin dhe të njoftohet për të drejtat e tij (neni 80). Pastaj në KPPK në kapituj të veçantë rregullohet procedura për realizimin e kërkesës pasurore juridike (kapitulli XII) dhe garantohet mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve (kap. XXI). Nga rregulloret e UNMIK-ut në lidhje me të drejtat e viktimave vlen të përmenden: Rregullorja nr. 2003/12: Mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje; Rreg. Nr. 2001/4 – Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë; Rreg. Nr.2001/20 – Mbi mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurën penale¹².

4. Nevoja për mbrojtjen e viktimës prej momentit të pësimit nga akti kriminal e deri në zgjidhjen e çështjes penale në tërësi

Të gjithë personat që kanë pësuar nga krimi, në rend të parë kanë nevojë për një mbrojtje adekuate. Këtu pikësisht kemi parasysh viktimat që kanë pësuar për herë të parë nga krimi, i ashtuquajturit viktimizim primar. Këto viktima mund të kenë pësuar në mënyrë direkte apo indirekte, dëmi që kanë pësuar mund të jetë i natyrës fizike, psikike, morale dhe materiale. Me një fjalë si persona për t'u ofruar mbrojtje konsiderohen të gjithë ata persona që njëherësh konsiderohen si viktima sipas akteve ndërkombëtare dhe kanë nevojë për një gjë të tillë.¹³ Orvatjet e deritashme në nivel ndërkombëtar për të

¹¹ Shih: Dispozitat e akteve të përmendura.

¹² Më gjerësisht shih. Aktet e lartpërmendura. Dispozitat e tyre do të jenë si bazë edhe në trajtimet e mëtuajtshme.

¹³ Shih: Deklarata e OKB-së.

përmirësuar pozitën e viktimave në administrimin e drejtësisë janë një pranim i faktit se sistemet kombëtare të drejtësisë shpesh janë fokusuar në kryesin dhe marrëdhëniet e tij/saj me shtetin, duke përjashtuar të drejtat, nevojat dhe interesat e viktimave¹⁴.

Një problem në vete me rastin e mbrojtjes së viktimave është ndërmarrja e masave që të mos ndodhë riviktimizimi i tyre apo i ashtuquajturit viktimizim sekondar. Mbijetuesit e krimit mund të ndiejnë viktimizimin përsëri kur të vendosin të shkojnë një hap më tej dhe të bisedojnë për krimin. Kjo mund të ndodhë përmes trajtimit intensiv dhe joadekuat nga ana e aktorëve brenda sistemit penal të drejtësisë dhe sektorit të mirëqenies sociale, e gjithashtu edhe gjatë pjesëmarrjes në procesin e hetimeve dhe gjykimit¹⁵. Në varësi të natyrës së krimit dhe të pozicionit të saj në ngjarje, pasojave të ardhura, shpesh viktimat kanë provuar edhe një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë. Pozicioni i viktimës është delikat dhe i vështirë në rastet e krimeve të tilla, si : plagosje, vrasje e të afërmeve të familjes, abuzimet seksuale, grabitjet etj. Shpesh viktimës i duhet të përballet me autorin e saj dhe të rikujtojë momentet me të vështira të kaluara më parë¹⁶. Andaj për të evituar një pasojë të tillë kërkohet që organet gjegjëse dhe personat që i trajtojnë viktimat e krimit të veprojnë me kujdes dhe profesionalizëm.

Për arritjen e këtij qëllimi nga shtete nevojitet hartimi i planeve për mbrojtje të viktimave të krimit, mbështetur në dispozita të qarta ligjore që iu garanton atyre realizim efikas të të drejtave dhe trajtim adekuat prej kontaktit të parë me organet përkatëse e deri në përfundim të rastit në lidhje me to. Në funksion të kësaj para së gjithash do të ishte një trajtim adekuat nga ana e policisë në kontaktin e parë me viktimat dhe marrjes në pyetje për here të parë, informimi dhe ofrimi i mbrojtjes juridike-profesionale dhe rregullimi me kujdes i procedurës për pjesëmarrje sa me të lehtë të viktimës në të gjitha fazat e procesit gjyqësor penal.

4.1 Trajtimi i viktimave të krimit nga policia dhe marrja në pyetje e tyre

Pasi të jetë kryer vepra, kontakti i parë i viktimës me sistemin e drejtësisë bëhet zakonisht përmes policisë dhe ky kontakt mund të vazhdojë gjatë një pjese të konsiderueshme të procesit gjyqësor¹⁷. Nga ky kontakt do të varen shumë rrjedha të procedurës lidhur me mbrojtjen e viktimave dhe kompensimin e tyre, por edhe lidhur me një punë më efektive

¹⁴ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë... publikim i cit. fq. 740.

¹⁵ Udhëzuesi... fq. 52.

¹⁶ Elezi, Ismet; Hysi, Vasilika: Politika kriminale, Tiranë 2006, fq. 199.

¹⁷ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë ... publikim. i cit. fq. 740.

për parandalimin e krimit dhe viktimizimit në shoqëri¹⁸. Bashkëveprimi i parë ndërmjet policisë dhe viktimës është thelbësor edhe në lidhje me atë se si viktima do ta përballojë viktimizimin dhe do ta rimarrë veten¹⁹. Në këtë drejtim është me rëndësi që ndihma e parë dhe mbrojtja e personave me nevojë fillimisht të ofrohet nga organet shtetërore dhe të koordinohet nga to, këtu roli i policisë është shumë me rëndësi.

Çështje me rëndësi por edhe mjaft delikate me rastin e procedimit policor është edhe marrja në pyetje e viktimave. Për këtë edhe aktet ndërkombëtare rekomandojnë që të veprohet me kujdes të posaçëm dhe të mos riviktimizohet viktima.²⁰ Me rastin e marrjes në pyetje viktima nuk duhet të vendoset në rolin e të akuzuarit, por duhet respektuar disa parime që përkojnë me nevojat e viktimave. Përveç kësaj është me rëndësi që policia të ketë një bashkëpunim të afërt, por vetëm profesional dhe sa të jetë e mundur të krijojë raport besimi me viktimat e krimit. Kjo njëherësh mund të siguroj bashkëpunimin dhe kontributin e viktimës në zgjidhjen e rastit, sepse të dhënat dhe informacionet e saj janë të pazëvendësueshme gjatë hetimit të rastit kriminal dhe zhvillimit të procesit penal në tërësi. Në anën tjetër kjo në fund do të garantonte edhe mbrojtje adekuate të të drejtave të viktimës së krimit.

4.2 Ndhimja juridike-profesionale për viktimat e krimit

Pas dhënies së ndihmës së parë, strehimit, ofrimit të shërbimeve të caktuara nga policia, është e nevojshme që para fillimit të procedurës gjyqësore viktimës së krimit t'i sigurohet edhe ndihma juridike-profesionale. Kjo në rend të parë, është me rëndësi për sigurimin e barazisë së palëve në proces, në anën tjetër kjo bëhet e domosdoshme kur dihet pozita e veçantë e viktimës së krimit dhe mundësia e cenimit të interesave të saj nga ana e kryerësit edhe gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore. Gjendja e viktimës e krijuar nën ndikimin e viktimizimit, e bën atë shpeshherë të pafuqishme që t'i kërkoj dhe mbrojë të drejtat e veta, e gjithashtu edhe që të angazhojë avokat mbrojtës. Mandej në të shumtën e rasteve viktima e krimit nuk ka as mundësi financiare që të paguajë për shërbimet juridike-profesionale të cilat i nevojiten.

Shumica e avokatëve mbështesin më mirë pafajësinë e të pandehurve derisa ata paguajnë, ndërsa viktimat e kanë shumë më të vështirë të paguajnë për punën profesionale të kryer.

¹⁸ Halili, Ragip : Viktimologjia, Prishtinë 2007, fq. 133.

¹⁹ Handbook on Justice for Victims: United Nations Office for Drug Control and Crime Prevention, New York, 1999 fq. 57.

²⁰ Shih: Raporti sqarues lidhur me Rekomandimin (nr. (85)11) mbi pozitën e viktimave në kornizën e ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale, pika C.

Sot, me akte ndërkombëtare parashihet obligimi i shtetit që të heqë shpenzimet rreth ndihmës juridike për viktimat e krimit. Gjithashtu në shumë vende ekzistojnë sot edhe qendra për ofrimin e shërbimeve juridike falas për viktimat e krimit.²¹ Momentalisht në Kosovë nuk ekziston ndonjë sistem i caktuar për dhënien e përkrahjes dhe ndihmës juridike për viktimat e krimit²². Pastaj duke marrë parasysh se deri me tani edhe avokatët por edhe zyrat e caktuara të cilat ofrojnë shërbime juridike janë më shumë të orientuara por edhe të përgatitur për mbrojtjen e interesave të të pandehurit, në të ardhmen është e nevojshme që kjo qasje të ndryshojë. Përveç të tjerash kërkohet të ngrihen qendra apo zyra enkas për ofrimin e ndihmës juridike për viktimat e krimit dhe të përgatiten kuadro që e njohin kuadrin ligjor në lidhje me të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e reagimit që i përshtatet veçorive të viktimave.

4.3 Mbrojtja e viktimave të krimit gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale

Faza e shqyrtimit gjyqësor është faza më e rëndësishme ku viktimat e krimit mund t'i realizojë të drejtat e saj ligjore. Si rregull seancat gjyqësore janë publike dhe viktimat apo familja e saj gjithmonë kanë të drejtë të marrin pjesë në këto seanca që janë të hapura për publikun. Përveç të drejtës të jenë të informuar për kohën e zhvillimit të procedurës penale dhe të marrin pjesë në të, viktimat e krimit i kanë edhe disa të drejta të tjera dhe masa mbrojtëse me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre gjatë procedimit gjyqësor të çështjes penale në lidhje me to. Në këtë drejtim gjykata ka një rol kyç.²³

Të drejtat dhe mbrojtja e viktimës së krimit gjatë shqyrtimit gjyqësor njëherësh janë parapara edhe me akte ndërkombëtare por edhe me ligje nacionale²⁴. Gjithashtu edhe KPPK dhe disa akte të tjera nga kjo fushë parashohin të drejtat e palës së dëmtuar (viktimës) gjatë pjesëmarrjes në procesin penal. Në këtë drejtim një rëndësi e posaçme i kushtohet fëmijëve, personave të moshuar, personave me çrregullime mendore ose me paaftësi mendore dhe viktimave të dhunës seksuale a gjinore. Mbrojtja juridike në mënyrë të veçantë duhet të sigurohet në rastet kur bëhet fjalë për viktimat e dhunës në familje. Kjo për arsye siç edhe ceket në literature se viktimat është në një situatë shumë delikate duke marrë parasysh faktin se viktimizohet në vendin që duhet të jetë me i sigurti për çdo njeri dhe nga personat që duhet të jenë me të besuarit. Në Kosovë, procedurat

²¹ Udhëzuesi... fq. 66.

²² Po aty, fq. 67.

²³ Shih : Raporti sqarues lidhur me Rekomandimin (nr. (85)11) mbi pozitën e viktimave në kornizën e ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale, pika D.

²⁴ Më gjerësisht shih: Rekomandimi Nr. R (85)11 ... pikat 9-11.

ligjore për mbrojtje të personave që viktimizohen në familje dhe disa masa parandaluese parashihen në Rregulloren e UNMIK-ut nr,2003/12 e cila ndër të tjera parasheh tri masa mbrojtëse si:

1. Urdhëresa për mbrojtje
2. Urdhëresa për mbrojtje emergjente
3. Urdhëresa për mbrojtja të përkohshme emergjente

Masa e parë me të cilën të pandehurit i bëhen disa kufizime dhe ndalesa me qëllim që të mbrohet siguria e palës së mbrojtur apo anëtareve të tjerë të familjes shqiptohet nga gjykata, e cili vendos për këtë brenda afatit prej 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Në rastet me emergjente parashihet masa e dytë për të cilën gjykata duhet të vendos brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës. Ndërsa në rastet kur gjykata nuk mund të veprojë është paraparë edhe masa e tretë “Urdhëresa për mbrojtja të përkohshme emergjente për të cilën është paraparë se mund ta shqiptojnë organet policore.

Çështje mjaft e ndjeshme paraqitet në rastet kur si viktimë janë të miturit. Kur janë ata në pyetje të miturit dihet se veprimet për mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore i ndërmerr prindi ose kujdestari, andaj në këtë drejtim me ligj duhet të parashihet përgjegjësia e tyre në rastet kur i zvarrisin ose nuk i ndërmarrin këto veprime. Një sanksionim i tillë nuk parashihet në legjislacionin e Kosovës. Këtë çështje organet kompetente duhet ta shohin me kujdes që në mënyrë specifike të rregullohet pjesëmarrja në procedure për mbrojtjen interesave të të miturve sepse çdo lëshim mund të sjell pasoja riviktimizuese për ta. Mendojmë se përkundër parashikimit të masave mbrojtëse në legjislacionin e Kosovës, që si të tilla janë në harmoni me parimet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare, problemi qëndron të realizimi i tyre në praktikë. Ky problem konsiderojmë se shfaqet si pasojë e mungesës së mjeteve të caktuara, mungesës së profesionalizmit në gjykatat tona dhe disa veçori të caktuara që ndërlidhën me gjendjen e përgjithshme që mbretëron aktualisht në vendin tonë.

Me rastin e trajtimit të viktimës në procedurë gjyqësore duhet të merret parasysh jo vetëm pozita e saj si palë e dëmtuar por edhe roli i saj si dëshmitare dhe burim i rëndësishëm i provave.²⁵ Informacionet të cilat mund t’i ofrojë i dëmtuari...në procedurë penale...kanë të bëjnë si me faktet që janë të rëndësishme për procedurë penale, ashtu edhe me rrethanat që kanë për qëllim realizimin e të drejtave të tij të gjëra, në bazë të të cilave

²⁵ Sahiti, Ejup : Psikologjia gjyqësore , Prishtinë 2007, fq. 128-129.

mund të thuhet se ai është figurë procedurale e dyfishtë²⁶. Duke marrë parasysh këtë rol të dyfishtë të viktimës së krimit me rastin e pjesëmarrjes në procedurë gjyqësore mund të përfundojmë se mbrojtja adekuate e saj gjatë kësaj faze të zhvillimit të procesit penal është edhe e rëndësisë së dyfishtë. Së pari, kjo mundëson realizimin e të drejtave të viktimës, zbutjen e pasojave që ka përjetuar nga krimi dhe evitimin e riviktimizimit eventual të saj, në anën tjetër, kjo bën të mundur edhe bashkëpunimin e viktimës me gjykatën dhënien e informacioneve nga ajo për të provuar veprimet e kryerësit dhe për të zgjidhur drejtë çështjen penale. Kështu konsiderojmë se në përgjithësi për të siguruar një rol aktiv të viktimës në një procedurë gjyqësore penale dhe procedurë tjetër si parakushte kryesore janë: infrastruktura e plotë ligjore për këtë qëllim dhe informimi i viktimave për mundësitë juridike të tyre.

5. Përfundime dhe Rekomandime

Trajtimi i viktimës së krimit, në veçanti çështja e mbrojtjes juridike të saj është një nga problemet me të mëdha të sistemit të drejtësisë penale dhe preokupim i opinionit profesional në përgjithësi. Të drejtat të cilat u takojnë viktimave të krimit me parashikimin e tyre në dokumente ndërkombëtare dhe nacionale janë ngritur në nivel të të drejtave ligjore dhe si të tilla konsiderohen pjesë integrale e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Mirëpo në nivel nacional në Kosovë si edhe në disa vende të tjera mbetet shumë aktuale nevoja për nxjerrjen e normave juridike nga kjo fushë me qëllim të garantimit se viktimat e krimit të ketë mbrojtje juridike adekuate prej momentit të pësimit e deri në përfundim të çështjes penale në lidhje me të.

Studimet dhe hulumtimet e ndryshme që janë bërë tregojnë se për një luftë efikase kundër kriminalitetit, përveç gjykimit dhe dënimit të kryesit është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë adekuate. Me rastin e ndërmarrjes së masave me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së nevojshme juridike duhet të merren në konsideratë nevojat specifike dhe pozita delikate e viktimës si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të. Gjithashtu duhet të pranohet se humbjet e viktimës mund të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme si: dëmtime fizike, vuajtje shpirtërore, humbja e të afërmeve dhe humbja në aspektin financiar. Këto humbje rekomandohet që të merren në konsideratë edhe nga një numër i madh i akteve ndërkombëtare që trajtojnë problemin e të drejtave të personave që kanë pësuar nga krimi.

²⁶ Po aty , fq. 128.

Si zgjidhje për të ardhmen, sidomos për ato vende që nuk kanë krijuar sa duhet kushte për përmirësimin e pozitës së viktimës, do të ishin:

- Nxjerrja e ligjeve, me qëllim të krijimit të parakushteve juridike për mbrojtjen e interesave të viktimës që ka pësuar nga krimi. Zgjidhja më e mirë në këtë drejtim do të ishte që këto ligje të jenë në harmoni me standardet e përcaktuara në mënyrë parimore në aktet ndërkombëtare nga kjo fushë, por duke marrë për bazë edhe nevojat reale të vendit përkatës.
- Informimi i viktimave të krimit për të drejtat ligjore që ato i kanë si persona që janë dëmtuar. Një informim i tillë do të realizohej në forma të ndryshme si p.sh. me krijimin e qendrave për informim të viktimave, shpërndarjen e informacioneve nëpërmjet mjeteve elektronike dhe atyre të shkruara etj.
- Mbi bazë ligjore krijimi i mekanizmave të domosdoshëm që mundësojnë realizimin e ndihmës për viktimat e krimit. P.sh. qendrave speciale për dhënien e ndihmës, ofrimit të mbrojtjes, strehimit dhe rehabilitimit të viktimave.
- Aftësimi i kuadrit profesional që ka për obligim të merret me viktimat e krimit prej kontaktit të parë e deri në përfundim të çështjes penale në lidhje me të, në mënyrë që të njohin të drejtat ligjore të viktimave dhe qasja ndaj viktimave të jetë në përputhje me gjendjen delikate të tyre.
- Krijimi i fondeve shtetërore dhe fondeve të tjera për realizimin e kompensimit si një nga të drejtat kryesore për viktimat.
- Krijimi i bazës ligjore për të vepruar organizatat joqeveritare dhe shoqatat bamirëse të cilat kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e krimit dhe krijimin e fondeve për kompensimin e dëmit që ato kanë pësuar nga krimi.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të masave për mbrojtje dhe kompensim të viktimave të krimit, sidomos sa i përket këmbimit të përvojave nga kjo fushë ndërmjet shteteve të ndryshme. Në veçanti kur është fjala për viktimat e krimeve transnacionale.

Bibliografia

Literaturë:

Adler, Freda dhe të tjerë : Criminology, New York, 1995.

Ashworth, Andrew, "Punishment and Compensation: Victims, Offenders and the State" (1986), 6 *Oxford Journal of Legal Studies*, 86.

Elezi, Ismet; Hysi, Vasilika: Politika kriminale, Tiranë 2006.

Elias, Robert: *The Politics of Victimisation: Victims, Victimology, and Human Rights*, New York, Oxford University Press, 1986.

Ewald ,Uwe: Viktima dhe viktimizimi, Instituti gjyqësor, Prishtinë, 2002

Fattah, Ezzat Abdel: "From Crime to Victim Policy: The Need for a Fundamental

Glick, Leonard: Criminology, Boston , 1997.

Halili, Ragip: Viktimologjia, Prishtinë 2007.

Halili, Ragip : Studimet viktimologjike dhe avancimi i shkencës së viktimologjisë, E drejta, Nr 4., 2003, Prishtinë.

Handbook on Restorative justice programmes, United Nations Office on Drugs and Crime, Vienna & New York. 2006.

Handbook on Justice for Victims; United Nations Office for Drug Control and Crime Prevention, New York, 1999.

Henting, Hans Von : The criminal and his victim, Archon Books, 1967.

Hopkins, Nick: Once a victim,always a victim, London1989.

Latifi, V. : Rëndësia e Viktimologjisë në të drejtën penale, E drejta Nr.1, 1979, Prishtinë.

Publikimi i OSCE, Mision në Kosovë , “Udhëzues për mbrojtjen e viktimave” Prishtinë 2002 .

Publikim i Këshillit të Evropës, “Pozita e viktimave në kornizën e ligjit dhe procedurës penale”

Sahiti, Ejup: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006.

Sahiti, Ejup: Psikologjia gjyqësore, Prishtinë 2007.

Sgarzi, Judith M & Mc Devitt, Jack: Victimology – A Study of Crime Victims and Their Roles, New Jersey, 2003.

Udhëzues për mbrojtjen e viktimave – Si të punohet me viktimat e krimit, OSCE, Misioni në Kosovë, Prishtinë, 2001.

Ukaj, Bajram: Kontributi i viktimës në kryerjen e veprave penale kundër sigurisë në komunikacionin automobilistik, E Drejta Nr.1/1995, Prishtinë.

Akte juridike:

Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985.

Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunës, Strasburg, 24.XI.1983.

Rekomandimi nr. R(99)19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ndërmjetësim në çështjet penale.

Rekomandimi Nr.(85)11 Mbi pozitën e viktimave në Kornizën e Ligjit Penal dhe të procedurës penale, miratuar me 28 qershor 1985.

Raporti sqarues lidhur me Rekomandimin (nr. (85)11) mbi pozitën e viktimave në kornizën e ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale.

Aneksi i Rekomandimit 2006/8 Mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

Ligji Penal për të Mitur i Kosovës.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/20, Për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedurën penale.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12, Për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.